



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.10.2018, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zv.kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 10 dhe 14 tetor 2019.
2. Shqyrtimi i kërkesës së përfaqësuesve të organizatave shqiptare të të drejtave të njeriut.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Adelina Rista, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhambulla, Bujar Çela, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Fatjona Dhimitri, Fidel Ylli, Klajdi Qama, Amra Barova, Enada Kapllani.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjes të gjithëve!

Sot do të zhvillojmë mbledhjen e radhës së komisionit në lidhje me postën zyrtare që ka ardhur në komision, për të cilën është mirë që të kthejmë përgjigje sa më shpejt, prandaj

jemi mbledhur sot këtu. Mbledhja do të jetë e shkurtër, kuptohet se vetëm një shqyrtim ka, ndërkohë që me sa shikoj, e kemi korumin e nevojshëm.

Dy janë pikat e rendit të ditës për sot.

Miratimi i procesverbaleve të datave 10 tetor, që ka të bëjë me seancë dëgjimore me Zv.ministren e Financave dhe Ekonomisë, znj. Dajna Sorensen, në lidhje me masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor 2019 – 2020 në sistemin parauniversitar të arsimit profesional, dhe 14 tetor, që ka të bëjë me diskutimin nen për nen të projektligjit “Për Rininë”. Nuk e di në i keni parë. Nëse keni komente, ju e dini që ne ia dërgojmë Arianës për korrigjim, ndaj kush ka komente, t’ia kalojë brenda ditës së sotme.

Ndërkohë kemi për të diskutuar letrën, në formë kërkesë, që i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit, zotit Ruçi, i cili ia ka kaluar komisionit tonë, e ardhur nga përfaqësues të organizatave shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilën Ariana na e ka nisur me *e-mail*. Pak a shumë, letra kërkon që kur të fillojë diskutimi për projektligjet "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ata të jenë pjesë e diskutimeve. Por ka një moment në këtë lloj kërkesë, jo shumë dashamirëse, pasi thonë që “ju e keni të shpallur në Kuvend këtë kalendar dhe nuk keni filluar të bashkëpunoni me ne”.

Për ta sqaruar komisionin dhe për të krijuar idenë se çfarë përgjigje duhet të kthejmë, që mund ta shikojë një grup i vogël prej nesh dhe pastaj të biem dakort, ne diskutimet për projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku jemi komision përgjegjës, dhe projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku jemi komision për dhënie mendimi, ende nuk i kemi filluar, sepse Kalendar i Kuvendit i ka shtyrë këto projektligje për një moment të dytë, pra, rrjedhimisht as ne nuk i kemi përfshirë në kalendarin e komisionit, e para.

E dyta, ne e kemi kusht të Regullores së Kuvendit, dhe të gjithë e dimë që ne e ndjekim Rregulloren, që sa herë kemi projektligje, duhet të thërrasim në dëgjuesë të gjithë ata që janë grupe interesi, gjë që përherë e bëjmë.

E treta, që është shumë e rëndësishme, është se me miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, grupet e interesit, shoqata apo organizata, që të marrin pjesë në

dëgjesa, duhet të rregjistrohen në *website*-in e Kuvendit. Dhe ajo që u bëjmë thirrje këtyre shoqatave është që përpara se të bëjnë kërkesën që të vinë në dëgjese, e cila në fakt nuk ka akoma një kalendar, duhet të rregjistrohen në Faqen e Kuvendit, që të bëhen pjesë e dëgjesave.

Me këto 3 shtylla, ne kalojmë letrën. Nuk e di nëse keni pasur kohë ta shikoni, nëse bini dakort për këtë lloj komunikimi që duam të bëjmë...

Musa Ulqini – Po, këto tre gjëra t'u themi atyre dhe mjafton.

Muhamet Bela – Letrën e ka bërë zëvendëskryetarja para disa ditësh dhe përmbajtja është e tillë që sqaron saktësisht situatën. Me të kemi komunikuar nëpërmjet e-mail-it.

Kemi konstatuar se këto shoqata nuk kanë qenë të mirinformuar që projektligjet për të cilët janë të interesuar, të jenë diskutuar në komisionin tonë. Komisioni gjithmonë në rastet e diskutimit të projektligjeve, ka ftuar aktorët e interesit dhe shoqërinë civile në senaca dëgjimore. Për mendimin tim, përgjigjja është shumë e saktë.

Milva Ekonomi – Atëherë dakort, u nisim letrën sqaruese.

Tjetra gjë që dua t'ju bëj me dije, është se sot në orën 15.10-16.00, do të zhvillohet një takim me një grup reporterësh, politikanë, që vijnë me një mision vëzhgimi faktmbledhës në Shqipëri dhe Kryetari ka caktuar kryetaren e Komisionit dhe mua për të marrë pjesë në këtë takim. Meqë kryetarja nuk është, duhet të flasim me kryesinë e komisionit?

Sekretarja – Unë ia bëra me dije Shërbimit të Marrëdhënieve me Jashtë të Kuvendit, i cili merret me organizimin e takimit dhe më thanë se ishte në rregull që do të jeni vetëm ju.

Milva Ekonomi – Në rregull, atëherë jemi gati për seancën plenare.

Ka ndokush tjetër për të shtuar?

Fadil Nasufi – Kemi mbledhje për nesër?

Milva Ekonomi – Jo, nuk kemi, pasi ne edhe e kemi mbaruar raportin për projektligjin “Për Rininë”; punoi Almira me Muhametin dhe e mbaruan dhe meqë kryetarja nuk ishte, siç e dini, e firmosa unë.

Sa për projektligjet për të cilat u diskutua këtu, ende nuk është caktuar datë për shqyrtimin e tyre në Kalendarin e Kuvendit.

Ne kemi për të bërë një dëgjese me ministren e Arsimit për fillimin e vitit të ri akademik. Duhet të komunikojmë me të.

Kemi lënë, gjithashtu, një vizitë në Vlorë, në Universitet, pas festimeve të 25 vjetorit të tij, si dhe në Shkodër.

Vilma Bello – Shumë mirë, jemi gati t’ju presim.

Milva Ekonomi – Pra, nëse jeni dakort, mund të shikojmë datën se kur mund ta zhvillojmë vizitën në Universitetin e Vlorës.

MBYLLET MBLEDHJA